

NË EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda, duke vendosur sipas Kryetarit te Trupit gjykues Naser Maliqi, me Zyrtaren Ligjore Zahide Rexhepi, ne qeshtjen penale te pandehurit D. J, per shkak te veprave penale mbajteja ne pronsi, ne kontrolle, ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 parag. 1, dhe per shkak te vepres penale perdorim i armës apo mjetit te rrezikshem nga neni 375 parag. 1 te KPRK-se, te cilin e mbron av. M.M, sipas detyres zyrtare dhe sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, Departametni per Krimet e Renda, PP/ I. nr.63/16, e dt. 18.03.2016, e pas mbajtjes e shqyrtimit fillestar me dt. 20.02.2017, shpalle:

AKTGJYKIM

I pandehuri D. J nga V dhe nëna T, e lindur S, i lindur me dt. ...ne fshatin M Komuna e K, ku edhe jeton, ka te kryer shkollën e mesme, punotor social ne QPS ne K, , i martuar, babai i dy fëmijëve, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, i R, te Kosoves.

ËSHTË FAJTORË

I.

Sepse në kohë të pa vërtetuar më parë e deri më date..., ka siguruar dhe mbajtë në pronësi, në mënyr te paautorizuar armën e zjarrit-pushkën "M.." , me nr. serik .. dhe .. fishek e të ciles i kishte skaduar leja e përdorimit nga data..., si dhe armën tjetër pushkën e gjuetisë të prodhimit jugosllav me nr. Serik..., per tecilën p[oashtu nuk ka poseduar leje për mbajtëjen e armës nga organi kompetent si dhe katër fishekë tjerë kal .. mm, një fishekë të kalibrit..., një fishekë të kalibrit ...mm, e që edhe me datën e lartcekur të njëjtat i janë gjetur dhe konfiskuar nga ana e pjestarëe të policisë së Kosovës,
-Me qka ka kryer veper penale mbajtëja në pronësi, në kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 parag. 1 të KPRK-së

II.

Sepse me datë ..., rrethë orës 21:40 në fsh, M..., në oborin e shtëpis së tij, ne kundërshtim me ligjin mbi armët ka përdorur pushkën e gjuetis të prodhimit jugosllav me nr. serik .., në atë mënyr që me të njëjtën ka shtënë dy herë dhe menjëher pas të shtënave është hasur nga patrulla e policisë në oborin e tij, ku me këtë rast i janë konfiskuar armët e përshkruara sin ë dispozitivin nr. I të kësaj aktakuze.

-Me cka ka kryer veprën penale, përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 1 të KPRK-, së

-Andaj në baze të nenit 4, 7, 17, 21, 36, 41, 42, 43, 46, 51, 73, 75, 76, të KPRK-se, dhe nenëve 365 dhe 453 të KPPRK-se

Konstaton:

-Për veprën penale mbajtëja në pronësi, në kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 parag. 1 të KPRK-së i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesqindë)euro .

-Për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 1 të KPRK-, së i shqipton dënim me burg në kohezgjatje prej 180 ditësh.

E GJYKON

Me dënim me gjobë prej 500,00 (pëqind) euro, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi, në të kundërtën ky dënim do të zëvendësohet me dënim burgu, dhe me dënim me burg në kohezgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim nuk do të egzekutohet, **me kusht** që në afat prej 1 (një) viti mos të kryej ndonjë veprë penale tjetër.

Konfiskohen Armët:

1-Arma e zjarrtë-pushkë “..” me nr. serik ..dhe .. fishekë.

2-Arma, pushkë e gjuetisë e prodhimit jugosllav me nr. serik 45869 si dhe katër fishek tjerë të kalibrit “..” dhe një fishek i kalibritë...

Detyrohet I pandehuri Dimitrije Jevtiq, që kesaj gjykate t' ia paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, të gjitha keto në afat prej 15 diteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktëgjykimi.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Renda, me dt.18.03.2016, ka ngritur aktakuzen PP/I, nr. 63/2016, ndaj te akuzuarve D. J , per shkak te vepres penale , mbajteja ne pronsi, ne kontrole, ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 parag. 1 te KPRK-se, dhe per shkak te vepres penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 1 te KPRK-se, dhe ka kerkuar që pas mbajatjes se shqyrtimit gjyqësor, te njejtit te shpallen fajtor dhe te denohen me denim meritor sipas ligjit.

Kryetari I trupit gjykues, me dt..., ka mbajtur seancen fillestare, ne te cilen I pandehuri D. J. ka pranuar ne tërsi veprat penale te cilat I vihen ne barre sipas dispozitivit I. dhe II. te aktakuzes, e ndien veten fajtor dhe ka kerkuar falje, duke cekur se ne te ardhmen nuk do te perseris vepra te tilla penale, I njejt ka deklaruar se pranimin e fajsisë e ka bere ne menyre vullnetare dhe pa presion nga askush dhe se eshte I vetedijshem per pasojat e ketij pranimi si dhe ne konsulltim me avokatin e tij, av. M. M.

Gjykata pas pranimit te fajsisë nga ana e te pandehurit dhe marrjes se mendimit nga ana e prokurorit te shtetit si dhe nga mbrojtësi i te akuzuarit D. Jav. M. M, e ka aprovuar kete pranim te fajsisë , sepse eshte ne pajtim me provat që gjinden ne shkresat e lendes dhe ate: raportin e policies i dates ...me nr., si dhe forma e konfiskimit te armeve "... " me numer serik . dhe ... fishekë, arma e gjuetis te prodhimit jugisllav me nr. Serik..., si dhe katër fishekë tjer kal.... mm dhe një fishek të kalibrit ...mm dhe fotodokumentacioni i se njejtës.

Gjat matjes dhe shqiptimit te denimit, Gjykata ka patur parasysh sjelljen e mire te te akuzuarit ne Gjykate, pranimin e fajesisë nga ana e te

pandehurit, eshte penduar thelle per kryerjen e ketyre veprave si dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla, duke shqiptuar denimet si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi, duke qenë e bindur se edhe me keto denime do te arrihet qellimi te i akuzuari, qe ne te ardhmen mos te kryej veprat te tilla dhe te ngjashme, por edhe te rrethi i tij ku jeton.

Per kete arsye u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi, ku I akzuar D.J eshte shpallur fajtor dhe gjykuar me denim me gjobe per vepren penale nen dispozitivin I. ne shume prej 500(pseqind) euro , ndërsa per vepren nën dispozitivn II, Gjykata I ka shqiptuar denim me burg prej 180 ditesh, me kusht qe ne aft prej nji viti mos t'i perseris veprat penale.

Armet dhe municioni i jan konfiskuar.

I **pandehuri** D. J. është detyruar që në emër të paushallit gjygjësor te paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA
Me dt, 20. 02.2017

Sek. Jurdike,
Zahide Rexhepi

Kryetari I trupit gjykues:
Naser Maliqi

KSHILLA JURIDIKE: kunder ketij aktgjykimi, palet e paknaqura munde te ushtrojne ankese ne afat prej 15 ditesh, nga dita e marrjes, ne Gjykatën e Apelit te Kosoves ne Prishtine, e nepermes kesaj Gjykate.